



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 23/2024 regjistri (JR)
Datë 25.06.2024

Nr. 63 i vendimit
Datë 12.12.2024

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– shpalli në seancë gjyqësore publike, më datë 12.12.2024, ditën e enjte, në orën 14:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Griselda Muçaj, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 23, datë 25.06.2024, që i përket:

ANKUESE: Komisionerja Publike Irena Nino.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 767, datë 29.05.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), në mungesë të subjektit të rivlerësimit, znj. Sofia Zhilla, e cila, me gjithë njoftimet e bëra, nuk u paraqit në seancë duke mos parashtruar asnjë shkak të arsyeshëm për mosparaqitjen e saj, dëgjoji Komisioneren

Publike, e cila përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 767, datë 29.05.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese dhe të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), znj. Sofia Zhilla ka ushtruar funksionin si inspektore pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe, bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës, ndaj saj ka nisur procesin e rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Komisioni, me vendimin nr. 767, datë 29.05.2024, ka vendosur të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Sofia Zhilla, pa një vendim përfundimtar, për shkak se ajo ka humbur statusin e subjektit të rivlerësimit. Komisioni ka arritur në këtë konkluzion duke mbajtur në vëmendje disa elemente të kuadrit faktiko-juridik të kësaj çështjeje dhe konkretisht që znj. Zhilla: (i) nuk e ka statusin e magjistratit; (ii) nuk e ka më funksionin e inspektore dhe nuk është larguar nga ky pozicion me dorëheqje; (iii) nuk mban aktualisht asnjë pozicion në sistemin e drejtësisë; dhe (iv) ka paraqitur një kërkesë për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit.
3. Komisionerja Publike Irena Nino, në datën 14.06.2024, ka paraqitur ankim kundër vendimit nr. 767, datë 29.05.2024, të Komisionit, duke kërkuar: *Ndryshimin e vendimit nr. 767, datë 29.05.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur: Ndërprerjen e procesit të rivlerësimit ndaj subjektit, znj. Sofia Zhilla. Ndalimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Sofia Zhilla, të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare.*
4. Subjekti i rivlerësimit, znj. Sofia Zhilla, ka paraqitur në datën 03.12.2024 në Kolegj, parashtrimet para seancës gjyqësore, regjistruar me nr. 708/22 prot., datë 03.12.2024, duke kërkuar lënien në fuqi të vendimit nr. 767, datë 29.05.2024, të Komisionit pasi është një vendim i bazuar në ligj dhe në prova. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga Kolegji të mbajë në konsideratë faktin se në datën 28.11.2024, ka mbushur moshën e pensionit të pleqërisë dhe në bazë të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 7703/1993”), ka kryer aplikimin në platformën e-albania, duke referuar dhe numrin e gjurmimit të këtij aplikimi. Në datën 04.12.2024, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Kolegj parashtrime shtesë, regjistruar me nr. {***} prot., datë 04.12.2024, në të cilat jep sqarime shtesë lidhur me procedurat që ka ndjekur për paraqitjen e kërkesës dhe aplikimin për përfitimin e pensionit të pleqërisë. Bashkëlidhur këtyre parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kopje të aplikimit të bërë në platformën e-albania, për pension pleqërie, kopje të tabelës që përcakton moshën e daljes në pension sipas ligjit nr. 7703/1993, si dhe kopje të kartës së identitetit.

5. Në seancën publike të datës 10.12.2024, Komisionerja Publike, në parashtrimet dhe konkluzionet përfundimtare, kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 767, datë 29.05.2024, të Komisionit. Ky kërkim i Komisioneres Publike u argumentua me faktin se sipas akteve të paraqitura në parashtrimet e datës 04.12.2024, rezulton se znj. Sofia Zhilla ka mbushur moshën për dalje në pension pleqërie dhe, për rrjedhojë, nuk bën më pjesë në rrethin e subjekteve që duhet t'i nënshtrohen procesit të rivlerësimit kalimtar, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, Komisionerja Publike vlerëson se në rastin konkret, objekti dhe qëllimi i procesit të rivlerësimit kalimtar është bërë i pamundur dhe nuk mund të vazhdojë në Kolegj.

II. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjyqimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

6. Lidhur me juridiksionin e Kolegjit, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, që kanë për objekt rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Çështja në shqyrtim që ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit nga Komisionieri Publik, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

7. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.
8. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit¹, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

9. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ankimi i Komisioneres Publike ndaj vendimit të Komisionit nr. 767, datë 29.05.2024, për subjektin e rivlerësimit, znj. Sofia Zhilla, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore publike. Znj. Sofia Zhilla nuk u paraqit në seancën gjyqësore të datës 10.12.2024, edhe pse kishte marrë dijeni rregullisht për zhvillimin e saj. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë kërkesë për shtyrjen

¹ Sipas dokumentit lajmërim marrjeje, regjistruar nga Institucioni i Komisionerëve Publikë, me numër {***} prot., datë 30.05.2024.

e seancës për ndonjë shkak të arsyeshëm, trupi gjykues vendosi vazhdimin e seancës gjyqësore publike pa praninë e saj.

10. Trupi gjykues, në shqyrtim të parashtrimeve shtesë të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në datën 04.12.2024, në bazë të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 45 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të çelë hetimin gjyqësor dhe të administrojë në cilësinë e provës kopjen e aplikimit të kryer nga znj. Sofia Zhilla për pension pleqërie, të gjeneruar nga platforma e-albania, dhe të vlerësojë këtë akt në raport me kërkimet dhe konkluzionet përfundimtare të Komisioneres Publike.

B. Mbi kërkimet e palëve

11. Në shqyrtim të kërkesës së Komisioneres Publike, si dhe të të dhënave që rezultojnë nga aktet e sjella me parashtrimet shtesë nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues çmoi se paraprakisht duhet verifikuar dhe identifikuar legjislacioni për përcaktimin e kushteve ligjore për përfitimin e pensionit të pleqërisë nga znj. Sofia Zhilla.
12. Nga aktet në fashikullin e Komisionit, rezulton se znj. Sofia Zhilla është emëruar në detyrën e inspektorese me vendimin e datës 18.3.2013 të KLD-së, me mandat 5-vjeçar pranë këtij institucioni nga juristët jomagjistratë dhe, më pas, me vendimin nr. {***}, datë 07.05.2018, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i është zgjatur mandati i inspektorit deri në krijimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Gjatë kësaj periudhe transitore, me krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ajo ka ushtruar pranë këtij organi, detyrën e inspektorese/nëpunëses përgjegjëse për vlerësimin profesional të gjyqtarëve.
13. Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas shqyrtimit të Raportit të Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin e Statusit Individual dhe Karrierën e Inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, lidhur me inspektoren Sofia Zhilla, me vendimin nr. {***}, datë 22.10.2019, ka vendosur deklarinimin e mospasjes së statusit të “magjistratit”, pasi ka konkluduar se *inspektorja Sofia Zhilla i kishte mundësitë për të konkurruar dhe plotësuar kushtet e përcaktuara sipas nenit 165 të ligjit nr. 96/2016, pasi nuk vinte nga radhët e gjyqtarëve në detyrë dhe nuk e dispononte statusin e magjistratit, por zgjodhi të mbante statusin aktual të inspektorit të ardhur nga radhët e jomagjistratëve*. Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, me urdhrin nr. {***}, datë 25.11.2019, ka liruar znj. Sofia Zhilla nga detyra e inspektorese së ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, *për shkak të mospasjes së statusit të magjistratit*.
14. Në referim të akteve të mësipërme të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe ligjit të zbatueshëm në situatën faktike konkrete, trupi gjykues vëren se në kushtet kur znj. Sofia Zhilla nuk e gëzon statusin e magjistratit, kushtet për daljen në pension pleqërie janë të ndryshme nga ato të magjistratëve, të parashikuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Për rrjedhojë, plotësimi i këtyre kushteve dhe verifikimi i tyre nuk bëhet nga ndonjë organ i përcaktuar me ligj, sikurse është parashikuar për magjistratët në ligjin nr. 96/2016². Në këtë rast, përcaktimi i kriterëve, midis tyre dhe i moshës,

² Ligji nr. 96/2016, neni 64, “Kohëzgjatja në detyrë e magjistratit”, pikat 1 dhe 5 parashikojnë se: “1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: [...] c) mbush moshën e pensionit të pleqërisë, sipas parashikimit të këtij ligji;

për përfitimin e pensionit të pleqërisë, i nënshtrohet drejtpërdrejt legjislacionit të përgjithshëm dhe bëhet sipas parashikimeve të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

15. Nga aktet, konstatohet se znj Sofia Zhilla ka lindur në datën {***} dhe ka mbushur moshën e pensionit të pleqërisë më datë 28.11.2024, sipas parashikimeve të ligjit nr. 7703/1993, në të cilin përcaktohet se për vitin 2024, moshë e daljes në pension për gratë, është 61 vjeç e 8 muaj³. Sipas akteve të paraqitura me parashtrimet shtesë të datës 04.12.2024, rezulton se znj. Sofia Zhilla ka aplikuar për përfitimin e pensionit të pleqërisë në datën 02.12.2024, në platformën e-albania, pas mbushjes së moshës së pensionit që përcakton ligji, aplikim i cili është pranuar nga kjo platformë si aplikim i suksesshëm.
16. Trupi gjykues vëren se znj. Sofia Zhilla, për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë, nuk bën më pjesë në rrethin e subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës⁴ dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016⁵. Në vlerësim të trupit gjykues, kjo rrethanë përbën shkak për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Sofia Zhilla, pa një vendim përfundimtar, pasi objekti dhe qëllimi për të cilin kishte nisur procedura e rivlerësimit kalimtar është bërë i pamundur dhe çdo çështje e lidhur me këtë proces, nuk mund të vazhdojë të shqyrtohet në Kolegj.
17. Në kushtet kur Aneksi i Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016 nuk kanë parashikuar ndonjë rregullim të posaçëm për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar në rastin e daljes në pension të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, bazuar në pikën 6 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, vlerëson se gjejnë zbatim parashikimet e nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative, i cili parashikon se: *Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.*

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, me shumicë votash,

[...] 5. Magjistrati del në pension pleqërie në moshën 67 vjeç. [...] Këshilli deklaroi me vendim mbarimin e statusit të magjistratit, jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës”.

³ Referuar tabelës së moshës së daljes në pension pleqërie, në nenin 92 të ligjit nr. 7703/1993.

⁴ “Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*”.

⁵ “Subjekt i rivlerësimit” janë të gjithë personat e parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës”.

VENDOSI:

Përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Sofia Zhilla, pa një vendim përfundimtar për çështjen, për shkak se objekti dhe qëllimi i këtij procesi është bërë i pamundur.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 12.12.2024.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi - kundër

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, kam votuar kundër vendimit (JR) nr. 63, datë 12.12.2024, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me të cilin është vendosur: *Përfundimi i procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Sofia Zhilla, pa një vendim përfundimtar për çështjen, për shkak se objekti dhe qëllimi i këtij procesi është bërë i pamundur* – për këto arsye:
2. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, paraqitet kjo situatë faktike:
 - 2.1. Znj. Sofia Zhilla, me vendimin nr. {***} të datës 18.3.2013 të KLD-së, është emëruar në detyrën e inspektore, me mandat 5-vjeçar pranë këtij institucioni dhe, më pas, me vendimin nr. {***} të datës 07.05.2018, i është zgjatur mandati i inspektore deri në krijimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
 - 2.2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Sofia Zhilla, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio* pasi në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ushtronte funksionin si inspektore pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe, bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
 - 2.3. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, znj. Sofia Zhilla ka nisur procedurat e rivlerësimit, duke plotësuar dhe dërguar brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji: *a.* deklaratën e pasurisë sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, pranë ILDKPKI-së; *b.* deklaratën për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, pranë DSIK-së; dhe *c.* formularin e vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale.
 - 2.4. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit, Komisioni, bazuar në nenet 33 dhe 39 të ligjit nr. 84/2016, administroi raportet e hartuara nga ILDKPKI-ja dhe DSIK-ja.
 - 2.5. KLGj-ja, pas shqyrtimit të Raportit të Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin e Statusit Individual dhe Karrierën e Inspektorëve të ish-KLD-së, lidhur me inspektoren Sofia Zhilla, me vendimin nr. {***}, datë 22.10.2019, ka vendosur deklarinimin e mospasjes së statusit të “magjistratit”, pasi ka konkluduar se: *inspektorja Sofia Zhilla i kishte mundësitë për të konkurruar dhe plotësuar kushtet e përcaktuara sipas nenit 165 të ligjit nr. 96/2016, pasi nuk vinte nga radhët e gjyqtarëve në detyrë dhe nuk e dispononte statusin e magjistratit, por zgjodhi të mbante statusin aktual të inspektorit të ardhur nga radhët e jomagjistratëve.* Ky vendim u ankimua nga znj. Zhilla pranë Gjykatës Administrative të Apelit, e cila me vendimin nr. {***}, datë 18.02.2020, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së paditëses Sofia Zhilla.
 - 2.6. KLGj-ja, pas vendimit nr. {***}, datë 22.10.2019, nxjerr urdhrin nr. {***}, datë 25.11.2019, me të cilin ka liruar znj. Sofia Zhilla nga detyra e inspektore së ish-KLD-së, duke ndërprerë marrëdhënien juridike dhe financiare të punës si inspektore. Ky urdher u ankimua nga subjekti i rivlerësimit dhe, në vijim, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. {***}, datë 4.6.2020, ka pranuar kërkesën e paditëses (Zhilla), duke rrëzuar

kështu urdhrin për lirim nga detyra – me pasojë ndërprerjen e marrëdhënies së punës me KLGj-në. Ky vendim i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është apeluar nga KLGj-ja, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. {***}, datë 06.02.2024, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. {***}, datë 04.06.2020, të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë.

2.7. Për të dyja vendimet e lartpërmendura të Gjykatës Administrative të Apelit, është paraqitur rekurs pranë Gjykatës së Lartë, të cilat janë në pritje për t'u shqyrtuar.

2.8. Komisioni, në vendimin objekt shqyrtimi, shprehet se:

[...] mosvijimi në pozicionin e inspektores – si shkak përcaktues për humbjen e cilësimit si subjekt rivlerësimi – ka ardhur jo për vullnetin e znj. Zhilla, e cila nuk ka paraqitur dorëheqje për t'u larguar nga funksioni i saj. Kësisoj, nuk evidentohet asnjë veprim i vullnetshëm i saj me qëllim shmangien nga nënshtrimi në procesin e rivlerësimit ex officio. Gjithashtu, edhe kërkesa e znj. Zhilla për “ndërprerjen/pushimin” e procesit të rivlerësimit, që ka përcjellë pranë Komisionit (në përgjigje të ftesës që i ishte bërë për t'u aktivizuar si pjesë/palë e këtij procesi), nuk mund të vlerësohet si një dorëheqje, por si një kërkesë për të evidentuar stadin aktual faktik, që nuk e cilëson më atë si një subjekt rivlerësimi.

[...] Në këto kushte, deduksioni logjik konsiston në faktin se askujt prej atyre që mund ta kenë humbur statusin e subjektit të rivlerësimit jo për vullnetin e tyre, pra pa dorëheqje, nuk mund t'i aplikohet ndalimi i parashikuar nga neni G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Duke qenë se rasti konkret gjendet në këto kushte, për sa kohë humbja e pozicionit funksional të inspektores ka ardhur për shkak të lirit nga detyra dhe jo nga dorëheqja, në konkluzion Komisioni çmon se për znj. Sofia Zhilla nuk duhet të aplikohet pika 2 e nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, në bazë të nenit 64, pika 1, shkronja “ç” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”⁶, si dhe nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative, me vendimin nr. 767, datë 29.05.2024, ka vendosur: të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Sofia Zhilla pa një vendim përfundimtar, për shkak se ajo ka humbur statusin e subjektit të rivlerësimit.

2.9. Duke mos qenë dakord me vendimin e Komisionit, më datë 14.06.2024, Komisionerja Publike Irena Nino ka ushtruar ankim, duke kërkuar: (i) ndryshimin e vendimit nr. 767, datë 29.05.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur: Ndërprerjen e procesit të rivlerësimit ndaj subjektit, znj. Sofia Zhilla. Ndalimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Sofia Zhilla, të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare. Në këtë ankim, Komisionerja Publike shprehet se konkluzioni i arritur nga Komisioni nuk qëndron, referuar edhe orientimeve në jurisprudencën e Kolegjit për mënyrën se si duhet të analizohet situata faktike dhe ligjore, për ndërprerjen e procesit të

⁶ Neni 64, pika 1, shkronja “ç” e ligjit nr. 96/2016, parashikon: “1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: [...] ç. shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji”.

rivlerësimit, kundrejt përmbushjes së kriterëve që passjellin zbatimin e nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

2.10. Ndërsa në parashtrimet përfundimtare, gjatë seancës gjyqësore publike të datës 10.12.2024, ndryshe nga ankimi, Komisionerja Publike kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 767, datë 29.05.2024, të Komisionit, me arsyetimin se sipas akteve të paraqitura në parashtrimet e datës 04.12.2024, rezulton se znj. Sofia Zhilla ka mbushur moshën për dalje në pension pleqërie dhe, për rrjedhojë, nuk bën më pjesë në rrethin e subjekteve që duhet t'i nënshtrohen procesit të rivlerësimit kalimtar, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, Komisionerja Publike vlerëson se në rastin konkret, objekti dhe qëllimi i procesit të rivlerësimit kalimtar është bërë i pamundur dhe nuk mund të vazhdojë në Kolegj.

2.11. Subjekti i rivlerësimit, me parashtrimet e paraqitura në Kolegj më datat 03.12.2024 dhe 04.12.2024, ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit nr. 767, datë 29.05.2024, të Komisionit, duke e vlerësuar një vendim të bazuar në ligj dhe në prova. Nëpërmjet parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Kolegjit të mbajë në konsideratë faktin se në datën 28.11.2024, ka mbushur moshën e pensionit dhe në bazë të ligjit nr. 7703/1993, duke referuar procedurat e aplikimit në platformën e-albania, për paraqitjen e kërkesës dhe aplikimin për përfitimin e pensionit të pleqërisë.

2.12. Trupi gjykues në Kolegj, në shqyrtim të parashtrimeve shtesë të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në datën 04.12.2024, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të çelë hetimin gjyqësor dhe të administrojë në cilësinë e provës kopjen e aplikimit të kryer nga znj. Sofia Zhilla për pension pleqërie, të gjeneruar nga platforma e-albania, dhe të vlerësojë këtë akt në raport me kërkimet dhe konkluzionet përfundimtare të Komisioneres Publike. Në përfundim, shumica e trupit gjykues, mbushjen e moshës së pensionit të pleqërisë, 61 vjeç e 8 muaj, nga znj. Sofia Zhilla, sipas parashikimeve të ligjit nr. 7703/1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, e vlerësoi si rrethanë që përbën shkak për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, pa një vendim përfundimtar, pasi objekti dhe qëllimi për të cilin kishte nisur procedura e rivlerësimit kalimtar është bërë i pamundur dhe çdo çështje e lidhur me këtë proces, nuk mund të vazhdojë të shqyrtohet në Kolegj.

3. Si gjyqtare në pakicë, konkluzionet në vendimin e Komisionit, ashtu edhe qëndrimi i Komisioneres Publike në parashtrimet përfundimtare në Kolegj, i ndryshëm nga ai i parashtruar në ankim lidhur me zgjidhjen përfundimtare të çështjes, i pranuar nga shumica e trupit gjykues, në vlerësimin tim, vijnë në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin e posaçëm nr. 84/2016, që përcaktojnë qartë qëllimin dhe subjektet që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit kalimtar. Për mua, si gjyqtare në pakicë, në kuadër të këtij procesi, i rëndësishëm paraqitet fakti i përcaktimit së pari, nëse znj. Sofia Zhilla është apo jo subjekt rivlerësimi sipas dispozitave të mësipërme, dhe së dyti, identifikimi i vullnetit të saj për t'iu nënshtrohet procesit të rivlerësimit kalimtar, sipas ligjit.
4. Në vlerësimin tim, si gjyqtare në pakicë, znj. Zhilla është subjekt rivlerësimi dhe duhet t'i nënshtrohet këtij procesi, për arsye se:

4.1. Znj. Sofia Zhilla është subjekt rivlerësimi, për shkak se në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese⁷ dhe të ligjit nr. 84/2016, ushtronte funksionin e inspektore pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe, bazuar në pikën 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, konsiderohet subjekt rivlerësimi dhe i nënshtrohet këtij procesi *ex officio*.

4.2. Përveç Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, statusin e subjektit të rivlerësimi e parashikojnë dhe dipozitat e ligjit nr. 96/2016, pavarësisht pasjen apo jo të statusit të magjistratit. Konkretisht, neni 165, pika 1 e këtij ligji parashikon se: *inspektori në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që nuk gëzon statusin e gjyqtarit ose prokurorit, janë subjekt i procesit të rivlerësimi, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*. Parashikimi i nenit 179/b të Kushtetutës i jep inspektorit të KLD-së, që gjendet në këtë detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, statusin e subjektit të rivlerësimi, të pakushtëzuar nga pasja ose jo e statusit të magjistratit.

4.3. Krahas dispozitave të mësipërme, subjekti i rivlerësimi, znj. Sofia Zhilla, ka shprehur vullnetin e saj të plotë, të pavesuar, të shkruar dhe të formalizuar, për të pasur statusin e magjistratit apo/dhe inspektorit dhe kthimin në vendin e mëparshëm të punës, duke kundërshtuar në rrugë gjyqësore deri në Gjykatën e Lartë, vendimet e KLGj-së.

5. Lidhur me identifikimin e vullnetit të saj për t’iu nënshtuar procesit të rivlerësimi kalimtar, si gjyqtare në pakicë, konstatoj se kërkesa për të mos iu nënshtuar këtij procesi, ndërkohë që ka pretenduar gjyqësisht se e gëzonte statusin e magjistratit apo/dhe inspektorit që e bëjnë atë subjekt rivlerësimi, duke kërkuar edhe rikthimin në pozicionin e mëparshëm, janë rrethana të cilat përfaqësojnë një situatë të kualifikueshme sipas nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Zbatimi i kësaj dispozite kushtetuese është pasojë ligjore e drejtpërdrejtë e ndërprerjes së procesit të rivlerësimi për të gjithë subjektet e rivlerësimi, të cilët, me vullnetin e tyre, nuk i nënshtrohen procesit të vlerësimi të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimi të aftësive profesionale, në funksion të kthimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Ka rezultuar e provuar se:

5.1. Pas hedhjes së shortit të datës 15.06.2021, Komisioni e ka njoftuar subjektin e rivlerësimi nëpërmjet postës elektronike, më datë 21.07.2021, mbi çeljen e hetimit administrativ, përbërjen e trupit gjykues, si dhe i dërgoi pyetësorin standard. Subjekti i rivlerësimi nuk konfirmoi marrjen e këtij njoftimi.

5.2. Në vijim të komunikimit të mëtejshëm, Komisioni i është ridrejtuar përsëri më datë 13.04.2023, në të gjitha adresat e deklaruara, duke i bërë me dije detyrimin ligjor si subjekt rivlerësimi për t’iu përgjigjur njoftimeve, si dhe duke i kërkuar të konfirmonte adresën/at elektronike. Subjekti i rivlerësimi nuk rezulton t’i jetë përgjigjur këtij njoftimi.

⁷ Me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”

5.3. Më datë 18.04.2023, Komisioni, nëpërmjet sekretarisë gjyqësore, arriti të komunikonte përmes telefonit me subjektin e rivlerësimit, e cila konfirmoi adresën e saj elektronike, por që më pas nuk iu përgjigj njoftimeve të dërguara nga Komisioni.

5.4. Me kërkesën e datës 12.06.2023, protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 14.6.2023, në përgjigje të njoftimit të Komisionit, subjekti i rivlerësimit është shprehur se: [...] *Dua t'ju vë në dijeni se kam qenë inspektore pranë KLGj-së nga viti 2013 deri në vitin 2019. Jam liruar nga detyra e inspektore dhe nuk kam ndonjë funksion tjetër, pranë ndonjë institucioni të drejtësisë. Lirimi im është bërë me urdhrin e nxjerrë nga Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. {***}, datë 25.11.2019. Për këtë shkak, unë nuk jam më subjekt i rivlerësimit nga ana juaj [...]. Në këto kushte, kërkoj ndërprerjen e procedurave të hetimit administrativ për subjektin Sofia Zhilla dhe pushimin e çështjes [...].*

5.5. Në vijim, Komisioni, me shkresën nr. {***}, datë 22.06.2023, drejtuar subjektit të rivlerësimit, shprehet se: [...] *në vijim të kërkesës suaj të datës 12.6.2023, për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit tuaj kalimtar, në alternativë të vijimit të procesit të rivlerësimit tuaj, mund të konkludojë me një vendim të ndërmjetëm të këtij procesi (bazuar pikërisht në kërkesën dhe vullnetin tuaj), dhe duke aplikuar edhe dispozitën e parashikuar në nenin G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, pasi t'ju dëgjojë në një seancë dëgjimore publike, nëse ju e vlerësoni të dobishme atë. Për sa më sipër, ju ftojme të shprehni qëndrimin tuaj për sa më lart, si dhe nëse ju dëshironi apo jo të paraqiteni në një seancë dëgjimore [...].*

5.6. Në përgjigje të shkresës së Komisionit, subjekti i rivlerësimit, më datë 05.7.2023, ka njoftuar, ndër të tjera, se: [...] *lirimi im nga detyra është bërë në kundërshtim me ligjin, nga drejtuesja e institucionit, për shkak të mosnjohjes së ligjit nga ana e saj. [...] Nëpërmjet kësaj shkrese, më njoftoni të drejtën time për të marrë pjesë në seancën dëgjimore që ju do të zhvilloni, për të vijuar më tej me vendimmarrjen për ndërprerjen e hetimit administrativ. [...] ju vë në dijeni se nuk do të marr pjesë në këtë seancë, pasi tashmë nuk kam asnjë detyrë shtetërore, që lidhet me procesin e rivlerësimit. Në këto kushte, paraqes qëndrimin tim për vijimin e seancës, pa praninë time, duke kërkuar ndërprerjen e procedurave të hetimit administrativ, për subjektin Sofia Zhilla dhe pushimin e çështjes [...].*

5.7. Edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, znj. Sofia Zhilla, nuk u paraqit në seancën gjyqësore publike të datës 10.12.2024, edhe pse kishte marrë dijeni rregullisht për zhvillimin e saj, si dhe nuk paraqiti asnjë kërkesë për shtyrjen e seancës për ndonjë shkak të arsyeshëm.

6. Në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar dhe interesit publik mbi këtë proces, aplikimi i nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, vjen si pasojë e vullnetit të subjektit për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, si dhe veprimeve të ndërmarra prej tij, që demonstronë përpjekje për t'iu shmangur apo për mos t'iu nënshtruar këtij procesi, si dhe mungesë predispozicioni dhe korrektësie në drejtim të organeve të rivlerësimit, duke mos përmbushur detyrimin ligjor për bashkëpunim dhe gatishmëri në këtë proces.

7. Në vlerësim tim si gjyqtare në pakicë, si Komisioni, ashtu edhe Kolegji duhet të kishin disponuar me aplikimin e nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, dhe ndalimin e subjektit të

rivlerësimit, znj. Sofia Zhilla, për t'u emëruar *gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare*, pasi situata e konstatuar në këtë çështje, bën të zbatueshme këtë dispozitë kushtetuese.

8. Për sa arsyetuar më sipër, rezulton e provuar në mënyrë të pakundërshtueshme, mungesa e vullnetit të subjektit të rivlerësimit për t'iu nënshtruar këtij procesi, dhe detyrimi ligjor i saj për të bashkëpunuar me Komisionin dhe Kolegjin. Në këto kushte, vlerësoj se shumica e trupit gjykues nuk duhet të kishte bazuar vendimmarrjen e saj vetëm në faktin që subjekti i rivlerësimit kishte dalë në pension pleqërie, por duhet të kishte analizuar qëndrimin e mbajtur prej saj deri në momentin e përfitimit të pensionit, i cili është shoqëruar me një indiferencë të subjektit të rivlerësimit ndaj organeve të rivlerësimit dhe tendencë të dukshme për t'iu shmatur këtij procesi.
9. Në mbështetje të situatës faktike më sipër dhe në analizë të legjislacionit të zbatueshëm, unë, gjyqtarja në pakicë, vlerësoj se në çështjen e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Sofia Zhilla, Kolegji nuk kishte hapësirë tjetër ligjore për të vlerësuar sjelljen e mbajtur nga subjekti i rivlerësimit, përveçse nëpërmjet zbatimit të nenit G, pika 2 të Aneksit e Kushtetutës.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi